



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Primitur / Dorezuar Priljeno/Prudato Received/Delivered	14.09	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org. Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBATI	3544/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.474/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, si dhe Vjollca Sinani-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.474/2023 të datës 09.03.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë

Kundër organit të punësimit Komuna e Shtimes, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.04.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.474/2023 të datës 09.03.2023 të parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet, Konkursi i datës 14.12.2022, për pozitën "Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale", për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale 2.
- III. Shfuqizohet, Vendimi i datës 28.02.2023, me numër protokolli 02/1-7, i Komisionit të Pranimit të Komunës së Shtimes dhe Njoftimi i renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 22.02.2023, si dhe të gjitha veprimet administrative që rrjedhin si pasojë e konkursit të datës 14.12.2022.
- IV. Shfuqizohet, Vendimi Nr.02-27 të datës 25.01.2023 i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Shtimes.
- V. Obligohet, Kryetari i Komunës së Shtimes që në afat prej përmbledhjet (15) ditësh nga pranimi i këtij vendimi që të bëjë zbatimin e të njëjtit.
- VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim sipas afatit ligjor pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Komuna e Shtimes duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 14.12.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 04.01.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale me numër të referencës RN00010592 lidhur me pozitat "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale/Komuna e Shtimes, për klasën e pozitës Profesional 2.

Ankuesja [redacted] ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 22.02.2023 sipas sistemit SIMBNJ nga ana e komunës së Shtimes, e njëjta është njoftuar lidhur me pikët e arritura, përkatësisht gjithsejtë 72 pikë, duke u renditur e treta (3) në këtë listë.

E pa kënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar nga ana e komisionit të pranimit, me datën 24.02.2023, ankuesja ka parashtruar ankesë në Komisionin për pranim e rekrutim dhe zhvillim te procedurave me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, Ligjit te Punës, dhe Vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike.

Me datën 28.02.2023, Komisioni për pranim e rekrutim dhe zhvillim te procedurave të lartcekura në Komunën e Shtimes, ka nxjerrë Vendimin me Nr.02/1-97, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit në Komunën e Shtimes lidhur me refuzimin e ankesës se saj si dhe njoftimit lidhur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatëve fitues, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.03.2023 fizikisht, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2515/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, Ligjit te Punës, dhe Vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 20.03.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtimes, ndërsa me datën 28.03.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:2515/2023 të datës 09.03.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.02/1-97 të datës 28.02.2023 të Komisionit të Pranimit; Ankesën e datës 24.02.2023 drejtuar organit të punësimit; Listën me renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 22.02.2023 e gjeneruar tek SIMBNJ; Kopjen e konkursit me numër të referencës RN00010592 të datës 14.12.2022; Vërtetim për i datës 01.12.2022 për ankuesen; Certifikatë Licencimi e datës 22.12.2022 nga Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare; Diploma e studimeve Bachelor i Sociologjisë e ankueses; Diploma e studimeve Master i Arteve në Administratën Publike e ankueses; Referencë e ankueses; Përgjigjeje në kërkesë e datës 28.03.2023; Lista e Aplikantëve në SIMBNJ; Njoftim për listën Përfundimtare të verifikimit paraprak të kandidatëve për grupin Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale e datës 30.01.2023; Rezultatet përfundimtare të konkursit, Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale e datës 01.03.2023; Pyetje për vlerësim me gojë nga N.H; Pyetje për vlerësim me gojë nga S.J; Pyetje për vlerësim me gojë nga B.F; Pyetje për vlerësim me gojë nga I.D; Shkresë e datës 29.05.2012; Certifikata e datës 10.01.2011; Certifikata e datës 10.05.2011; Vërtetim i Institucionit Parashkollor "Foleja" e datës 10.03.2010; Kontratë e veçantë shërbimi Nr.18-03/11 nga MAP; Letërnjoftimi i M.Q; Certifikatë nga Gjykata Themelore-Ferizaj e datës 30.11.2023; Shkresë e datës 29.03.2023; Aplikacioni i kandidatit Xh.R; Diplomë e datës 15.05.2015; Certifikatë e Xh.R. e datës 29.07.2013; Certifikatë Licencimi e datës 02.11.2021; Letërnjoftimi i Xh.R; Certifikatë mbi dënimet penale e Xh.R; Certifikatë e Xh.R. e datës 18.03.2022; Vërtetim mbi marrëdhënien e Punës e Xh.R; Referencë letër e datës 15.06.2022; Letër Referencë e Xh.R. e datës 20.06.2022; Aplikacioni i kandidatit V.H; Diploma e studimeve Jurist i Diplomuar-Bachelor e datës 06.04.2012; Diploma e studimeve Master në të Drejtën Kushtetuese dhe Administrative e datës 13.02.2017; Marrëveshje për Angazhim në Masën Aktive të Tregut të Punës e datës 01.10.2019; Marrëveshje për Angazhim në Masën Aktive të Tregut të Punës e datës 01.03.2019; Vërtetim i datës 15.05.2020; Kontratë Pune për Mësimdhënës e datës 30.03.2017 e V.H; Kontratë Pune për Mësimdhënës e datës 01.09.2017 e V.H; Kontratë Pune për Mësimdhënës e datës 06.02.2018 e V.H; Vërtetim i datës 29.03.2018; Referencë e datës 10.05.2013; Vërtetim i Praktikes i datës 27.02.2013; Vërtetim i datës 08.01.2018; Vërtetim i datës 18.02.2017; Performanc e datës 22.12.2020; Vërtetim i datës 08.07.2022; Marrëveshje për shërbime të veçanta; Letër Referencë e datës 10.01.2014; Vërtetim i datës 18.02.2017; Certifikatë e datës 19.07.2022; Letërnjoftim i V.H; Certifikatë e datës 19.09.2012; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i V.H; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i Xh.R; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i M.Q; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i V.H; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i Xh.R; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i M.Q; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i Xh.R; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i M.Q; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i V.H; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i V.H; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i Xh.R; Formular për vlerësimin individual të jetëshkrimit (Cv) të kandidatëve për vendin e punës i M.Q; Njoftim për listën Përfundimtarë te verifikimit paraprak te kandidateve e datës 30.01.2023; Vendim për formimin e komisionit për pranim në shërbimin civil; Aplikacioni i A.R; Diploma e studimeve Bachelor i Sociologjisë e datës 13.07.2015; Vendim i datës 13.10.2014; Vendim i datës 27.10.2014; Letër Reference; Marrëveshje për angazhim në masë aktive të tregut të punës e datës 05.08.2019;

Marrëveshje për angazhim në masë aktive të tregut të punës e datës 05.02.2020; Shkresë e datës 14.10.2021; Shkresë e tetor 2021-prill 2022; Shkresë e datës 26.10.2021; Shkresë e datës 13.10.2021; Certifikatë e datës 19.05.2017; Certifikatë e datës 18.12.2015; Certifikatë e datës 28.04.2017; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 06.01.2023; Certifikatë e datës 18.12.2015; Letër Reference; Letërnjoftimi i A.R; Vendimi për formimin e komisionit për praninë në shërbimin civil e datës 27.01.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuseses _____ është e bazuar, *Sepe*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore fillimisht ju referua dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L - 114 përkatësisht nenin 6 paragrafi 1, në të cilën dispozitë parashihet: "Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve" si dhe nenin 7 paragrafi 1 që ka të bëjë me parimet e e pranimit të zyrtarëve publikë dhe parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë, në të cilat nenë specifikisht parashihet: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të pretendimit ankimor sa i përket ligjshmërisë së komisionit të pranimi, u kujdes që të analizoj me kujdes dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L - 114 përkatësisht nenin 34 paragrafi 12 në të cilin nenë shprehimisht potencohet: "Komisioni i pranimi përbëhet nga të paktën 5 persona, me këtë përbërje: një (1) përfaqësues nga Njësia përgjegjëse; tre (3) nëpunës civilë të nivelit të mesëm apo të ulët, drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi, dhe një (1) ekspert i jashtëm në procesin e përzgjedhjes nga organizata të specializuara apo universitetet. Në cilësinë e vëzhguesve një nga sindikata dhe një nga shoqëria civile", gjithashtu kolegji i këshillit në këtë rast ndërliður me nenin e përcaktuar si më lartë analizoi edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 18 në të cilin nenë shprehimisht është e rregulluar çështja e përbërjes së komisionit të pranimi dhe at si në vijim: "1. Për konkurrimin në një Institucioni Tjetër Shtetëror, institucioni themelon një Komision Pranimi për të gjitha Grupet për të cilat zhvillohet konkurrimi. 2. Komisioni i Pranimi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni përbëhet nga: 2.1. një (1) anëtar nga Njësia Përgjegjëse, i cili kryeson komisionin; 2.2. tre (3) anëtarë nga nëpunësit civilë të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues që ushtrojnë detyrën në pozita punë të specializuara lidhur me fushën e njohurive, aftësive dhe cilësive për të cilat kryhet vlerësimi i kandidatëve; 2.3. një (1) ekspert i jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore, nga organizata të specializuara apo universitetet e fushës. 3. Kryetari dhe Anëtarët sipas paragrafit 2 nënparagrafëve 2.1 dhe 2.3 të këtij neni janë të njëjtë, pavarësisht nga Grupi për të cilin zhvillohet konkurimi, ndërsa anëtarët sipas nënparagrafit 2.2 përcaktohen ad hoc për sicilin Grup. 4. Anëtarët sipas nënparagrafit 2.2 mund të përzgjidhen ndër nëpunësit civil të vetë institucionit apo të një institucioni të administratës shtetërore të specializuar në fushën përkatëse. 5. Komisioni i pranimi ka mandat dy (2) vjeçar, dhe themelohet nga

udhëheqësi administrativ më i lartë i Institucionit Tjetër Shtetëror me propozim të Njesisë të Burimeve Njerëzore të institucionit. Anëtarëve të komisionit nuk mund t'i zgjatet mandati në të njëjtin komision dy here në vazhdimësi. 6. Paragrafët 4 dhe 6 të nenit 17 të kësaj Rregulloreje, zbatohen përshtatshëmrisht dhe në këtë rast" dhe në këtë bazë të specifikuar si më lartë kolegji i këshillit konstaton se përbërja e komisionit të pranimit nuk është konformë dispozitave të potencuara më lartë për faktin se në përbërje të komisionit është një anëtar përkatësisht kryesues i komisionit të pranimit i cili ishte caktuar paraprakisht në pozitë të ushtruesit të detyrës përmes vendimit Nr.02-27 të datës 25.01.2023 nga pozita e asistentit administrativë në Drejtori të Administratës në pozitë të U.d. të Udhëheqës i Personelit pa u bazuar në asnjë dispozite të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L - 114, si ligj bazik në shërbimin civil, nga se ky ligj plotësimin e një pozite të lirë e rregullon përmes nenit 32 paragrafi 4 dhe at si në vijim: "Përfundimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo muungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës", ndërsa specifikisht edhe ngritjen në detyrë e ka rregulluar përmes nenit 39 ndërsa në paragrafin 9 shprehimisht parashihet: "Deri në plotësimin përfundimtar të vendit të lirë, nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm të nëpunësit në interes të institucionit, të përcaktuar në nenin 52 të këtij ligji", ndërsa neni 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 sa i përket transferimit të përkohshëm parasheh: "1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në at që u tha më lartë konstaton se përbërja e komisionit të pranimit nuk është në harmoni me Ligjin e Zyrtarëve Publik Nr. 06/L - 114 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës edhe për faktin se procedura, forma dhe mënyra e zëvendësimeve të përkohshme përkatësisht transferimeve të përkohshme pa përfillur procedurat ligjore të potencuara si më lartë, përderisa sipas nenit 83-dispozitat transitorë paragrafi 10 të Ligjit për Zyrtarëve Publik Nr. 06/L - 114 parashihet: "Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës kthehen në vendin punës", që nënkupton se tashmë sipas legjislacionit të zyrtarëve publik nuk ka pozita në Shërbimin Civil me emërtim ushtrues të detyrës sikur ka ndodhë në rastin konkretë përmes vendimit Nr.02-27 të datës 25.01.2023 përveç që të aplikojnë dispozitat e nenit 32 paragrafi 4 sa i përket zëvendësimeve të përkohshme si dhe dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 sa i përket transferimeve të përkohshme, andaj në këtë kuptim bazuar në një veprim të paligjshëm përkatësisht akt administrativ të paligjshëm nuk mund të legalizohet një komision i pranimit i cili duhet të krijohet sipas procedurave ligjore, poashtu edhe nëse i referohemi vendimit Nr.02-27 të datës 25.01.2023 përmes së cilit ishte emëruar në pozitë të udhëheqësit të personelit sa i përket strukturës dhe elementeve të detyrueshme të aktit administrativ i njëjti duhet të jetë në harmoni me Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe at në nenin 47 të këtij ligji si në vijim: "1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika.

Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 20 / 21 QERSHOR 2016, PRISHTINË 17 Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”, dhe nenin 48 paragrafi 2: “Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”, andaj edhe në këtë kuptim Vendimi Nr.02-27 i datës 25.01.2023 nuk është në harmoni me Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë nuk mund të prodhojë pasoja juridike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në at që u tha si më lartë konstaton se anëtari i komisionit të pranimit në cilësi të kryesuesit fillimisht në mënyrë të paligjshme përmes një vendimi Nr.02-27 i datës 25.01.2023 mbi bazë ligjore të specifikuar si më lartë nuk ka pasur të drejtë të caktohet në at pozitë të U.d. Udhëheqësit të Personelit nga se nuk është respektuar asnjë dispozitë ligjore si e parasheh Ligji për Zyrtarëve Publik Nr. 06/L - 114, me rastin e zëvendësimeve apo transferimeve të përkohshme e rrjedhimisht i njëjti nuk ka pasur të drejtë që përmes një procedure të paligjshme të caktimit të përkohshëm në një detyrë të caktohet anëtar përkatësisht kryesues i komisionit të pranimit, andaj mbi këto arsye Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka vendosë që të anulojë procedurën e regrutimit sipas këtij konkursi që është objekt i kësaj ankese dhe poashtu të shfuqizoj edhe vendimin vendim Nr.02-27 i datës 25.01.2023 nga se i njëjti është i kundërligjshëm nga se referuar ligjit Nr. 06/L -048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenit 4 paragrafi 1 ku thuhet : “Këshilli është organ i pavarur që i raporton kuvendit të Kosovës dhe që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”, dhe në këtë kuptim të kësaj baze ligjore me rastin e shqyrtimit të ankesave kur konstaton shkelje të dispozitave që rregullojnë shërbimin civil atëherë ndërmer veprimet sipas detyrës zyrtare me qëllim që të mbrojë rregullat dhe parimet në Shërbimin Civil nga shkeljet ligjore materiale dhe procedurale që bëhen nga institucionet përkatëse, dhe në këtë kontekst të asaj që u tha më lartë obligohet Zyrtari Kryesor Administrativë në këtë rast Kryetari i Komunës së Shtimes ndërmer veprimet sipas dispozitivit të këtij vendimi, nga se është obligim ligjor i tij që të ndërmer veprimet administrative konform vërejtjeve dhe të gjeturave të këtij vendimi me qëllim që të kthejë ligjshmërinë në këtë proces dhe në proceset në vijim që lidhen me regrutim të nëpunësve civil, nga se pasojat juridike përmes mosveprimit konform këtij vendimi mund të jenë të pariparueshme përkatësisht cenojnë rëndë procesin e regrutimit në të ardhmen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave fillimisht me qenë se konstatoi se komisioni i pranimit nuk është i bazuar në legjislacionin e zyrtarëve publik dhe përkundër pretendimeve tjera të ankuesit nuk u lëshua në shtjellim të tyre nga se nuk kishin ndonjë efekt që mund të kenë ndikim në vendim ndryshe nga ky që është marrë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048

për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.474/2023, datë 14/04/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtimes dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.